

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në trupin gjykues të përbërë nga:

- 1) Gjyqtari i EULEX-it, z. Francesco Florit, kryetar i trupit gjykues,
- 2) Gjyqtari vendor, z. Ferid Beslimi, anëtar i trupit gjykues,
- 3) Gjyqtari i EULEX-it, z. Dragomir Yordanov, anëtar i trupit gjykues,

të ndihmuar nga procesmbajtësi i poshtëshënuar, në lëndën penale kundër:

Agron Haradinaj, i lindur me 17 korrik 1966 në Gllogjan, Deçan,

Agim Hoti, i lindur me 31 tetor 1981 në Polac, Skenderaj,

Mentor Qela, i lindur me 6 maj 1979 në Jabllanicë, Gjakovë,

Driton Spahiu, i lindur me 27 dhjetor 1975 në Mitrovicë,

A N, i lindur me 10 qershor 1978 në Gjakovë,

Pas mbajtës së shqyrtimit gjyqësor, në prezencë të prokurorit publik, të akuzuarave dhe avokatëve të tyre mbrojtës;

pas mbledhjes së trupit gjykues për vendimmarrje të mbajtur me 20 nëntor 2009, në pajtim me nenin 390 dhe 391 të KPPK-së;

shpall këtë:

DISPOZITIV

Agim Hoti, **Mentor Qela** dhe **Driton Spahiu** shpallen fajtor për veprat penale të tentim vrasjes së rëndë sipas nenit 147, paragrafi 1, pika 4 dhe neni 20 në bashkëkryerje, ish-neni 23 i KPPK-së dhe për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328, paragrafit 2 të KPK-së, përkatësisht secili nga ta ngarkohet për;

Në mënyrë specifike, të akuzuarit juanë përgjegjës për krimet si në vijim:

Agim Hoti dhe Mentor Qela

1. Më 28 shkurt 2007, rreth orës 08:00, të pandehurit Agim Hoti dhe Mentor Qela, të armatosur me pushkë automatike dhe revole TT, kanë shkuar në fshatin Gjergjicë, komuna e Drenasit dhe sapo kanë vërejtur se po afrohej automjeti Toyota Land Cruiser me targa 451 KS 443, në të cilin po udhëtonte A B, me qëllim të privimit nga jeta, fillimisht i

pandehuri Mentor ka shtirë shtatë herë me revolen TT në drejtim të automjeti të palës së dëmtuar A B; në ndërkohë që i pandehuri Agim Hoti ka shtirë 12 herë me pushkë automatike duke goditur pjesën e pasme të djathtë të automjetit me një plumb. Në këtë rast, gjithashtu është rrezikuar jeta e J Kt, Monika Kt dhe Jetmira Mt nga Peja, pasi që ata po udhëtonin së bashku me të dëmtuarin Anton Berish. Pas kryerjes së veprës penale këta të pandehur kanë ikur nga vendi i ngjarjes.

Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahiu:

2. Më 12 prill 2007, rreth orës 16.15, të akuzuarit kanë bërë përpjekje që të privojnë nga jeta të dëmtuarin A B si dhe kanë rrezikuar jetën e I Gt, F St, A Mt, G Zt dhe Driton Rugovs, të gjithë policë të SHPK-së nga Njësia për Mbrojtje të Afërt në Prishtinë, në atë mënyrë që të pandehurit Agim Hoti dhe Mentor Qela kanë angazhuar edhe të pandehurin Driton Spahiun dhe pastaj edhe të pandehurit Agim Hotin dhe Mentor Qelen, të pajisur me lansues raketash të tipit “ZOLLA”, dhe i pandehurit Driton Spahiu i pajisur me granata dore, janë pozicionuar buzë rrugës në fshatin Gjergjicë, komuna e Drenasit, në rrugën kryesore Prishtinë-Pejë dhe pastaj të pandehurit Agim Hoti dhe Mentor Qela kanë shtirë me “ZOLLË”, dhe i pandehurit Driton ka hedhur një granatë dore në drejtim të automjetit të policisë “KIA” me targa 093 KS 130, në të cilin po udhëtonte i dëmtuari A B, i shoqëruar nga personat e lartpërmendur. Në këtë rast, një nga predhat e ZOLLËS ka depërtuar në pjesë e përparme të automjeti duke i shkaktuar lëndime trupore pjesëtarit të SHPK-së, të dëmtuarit I Gt, i cili po drejtonte automjetin në atë kohë. Fatmirësisht, e njëjta predhë nuk ka eksploduar ndërsa predha tjetër ka eksploduar ndërmjet dy automjeteve në rrugë, duke ju shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale dy automjeteve tjera të policisë dhe pastaj të pandehurit Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahiu kanë ikur nga vendi i ngjarjes në drejtim të pyllit mbi fshatin Gjergjicë, por pas intervenimit të pjesëtarëve të SHPK-së nga stacioni policor i Drenasit ata janë kapur dhe janë arrestuar.

Në këtë mënyrë, të pandehurit Agim Hoti dhe Mentor Qela kanë kryer dy vepra penale të tentim vrasjes së rëndë nga neni 147, paragrafi 1, pika 4 dhe neni 20 në bashkëkryerje, ish-nenit 23 i KPPK-së, ndërsa i pandehuri Driton Spahiu ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentative nga neni 147, paragrafi 1, pika 4 dhe neni 20 në bashkëkryerje, ish-nenit 23 i KPPK-së;

Përveç kësaj, të akuzuarit **Agim Hoti**, **Mentor Qela** dhe **Driton Spahiu** shpallën fajtor për veprat penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328, paragrafit 2 të KPK-së përkatësisht secili nga ta ngarkohet për;

Në mënyrë specifike, të akuzuarit juanë përgjegjës për krimet si në vijim:

Agim Hoti

Në kohë të panjohur dhe pa autorizim, ai ka marrë dhe mbajtur në posedim si dhe ka bartur armë zjarri, me saktësisht një pushkë automatike AK-47 dhe një lansues raketash

të tipit "ZOLLA" me nr. serik 91-14 1546-64mm 80 dhe i ka shfrytëzuar këto armë në kohën dhe vendin e cekur në pikat 1 dhe 2 të diapozitivit të kësaj aktakuze.

Mentor Qela

Në kohë të panjohur dhe pa autorizim, ai ka dhënë, poseduar dhe bartur armë zjarri, më saktësisht dy pushkë automatike AK-47, me numra serik 1985 – M 76 dhe 3108 189, dy plumba 12 mm, një revole TT si dhe një lansues raketash të tipit "Zolla" me numër serik 91-05 2376 64 mm M 80, kurevolja dhe lansuesi i raketave janë përdorur në kohën dhe vendin e cekur në pikat 1 dhe 2 të diapozitivit të kësaj aktakuze.

Driton Spahiu

Në kohë të panjohur dhe pa autorizim, ai ka marrë dhe mbajtur në posedim si dhe ka bartur armë zjarri, me saktësisht tri granata dore të prodhimit jugosllav dhe e ka përdorur njërën në kohën dhe vendin e cekur në pikën 2 të dispozitivit të kësaj aktakuze, ndërsa dy të tjerat i janë konfiskuar në të njëjtën ditë kur është zënë dhe arrestuar nga pjesëtarët e SHPK-së në pyll në fshatin Gjergjicë, komuna e Drenasit.

- - -

Në bazë të nenit 390, pikës 3 të KPPK-së,

Agron Haradinaj

Në lidhje me të njëjtat veprat penale të përmendur me lartë shpallet i pafajshëm prandaj edhe lirohet.

- - -

Për arsytet e lartpërmendura, trupi gjykues shall këtë:

DËNIM

1. Agim Hoti

Në pajtim me nenet 38, 20, 65(2), nenin 147, paragrafin 1, pikën 4, dhe nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) për krimin e kryer me 28 shkurt 2007, i pandehuri Agim Hoti dënohet me 12 vite burgim;

Në pajtim me nenet 38, 20, 65(2), 66, 147, paragrafin 1, pikën 4, dhe nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) për krimin e kryer me 12 prill 2007, i pandehuri dënohet me 14 vite burgim;

Në pajtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 vit e katër muaj burgim;

Në pajtim me nenin 71, paragrafin 1 dhe 2, pikën 2 të Kodit Penal të Kosovës, i pandehuri Agim Hoti, **detyrohet të vuaj dënimin me burgim prej 16 viteve.**

2. Mentor Qela

Në pajtim me nenet 38, 20, 65(2), nenin 147, paragrafin 1, pikën 4, dhe nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) për krimin e kryer me 28 shkurt 2007, i pandehuri Mentor Qela dënohet me 17 vite burgim;

Në pajtim me nenet 38, 20, 65(2), nenin 147, paragrafin 1, pikën 4, dhe nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) për krimin e kryer me 12 prill 2007, i pandehuri dënohet me 20 vite burgim;

Në pajtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 vit e katër muaj burgim;

Në pajtim me nenin 71, paragrafin 1 dhe 2, pikën 2 të Kodit Penal të Kosovës, i pandehuri Mentor Qela, **detyrohet të vuaj dënimin me burgim prej 20 viteve.**

3. Driton Spahiu

Në pajtim me nenet 38, 20, 65(2), nenin 147, paragrafin 1, pikën 4, dhe nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) për krimin e kryer me 12 shkurt 2007, i pandehuri Driton Spahiu dënohet me 15 vite burgim;

Në pajtim me nenin 328, paragrafin 2 të KPK-së, i pandehuri dënohet me 10 muaj burgim;

Në pajtim me nenin 71, paragrafin 1 dhe 2, pikën 2 të Kodit Penal të Kosovës, i pandehuri Driton Spahiu, **detyrohet të vuaj dënimin me burgim prej 15 viteve dhe 6 muajve.**

Koha të cilën të pandehurit Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahiu e kanë kaluar në paraburgim nga 12 prill 2007 deri kur marrjen e aktgjykimit të plotfuqishëm do të llogaritet si pjesë e burgimit në pajtim me nenin 73 të KPK-së.

Trupi gjykses,

duke pasur parasysh se me datën 11 nëntor 2009 prokuroi ka tërhequr akuzën kundër A Nt në lidhje me pikën e fundit të aktakuzës,

pas leximit të nenit 389 të KPPK-së

HEDH POSHTË

akuzën kundër të akuzuarit.

KËRKESA PRONËSORE

Të akuzuarit Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahiu, në mënyrë kolektive dhe së bashku, duhet ta kompensojnë të dëmtuarin I Gn për dëmet e shkaktuara. Të dhënat e paraqitura në procedurën penale nuk ofrojnë një pazë të besueshme për një kompensim të plotë apo të pjesshëm; prandaj gjykata e udhëzon të dëmtuarin që të paraqes një padi civile për tërë kërkesën në pajtim me nenin 112 (2) të KPPK-së.

SHPENZIMET

Në pajtim me nenin 102, paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), personat e dënuar detyrohen që t'i paguajnë shpenzimet procedurale të cilat duhet të paguhen në shumën e përgjithshme prej 350 euro.

KONFISKIMI

Në pajtim me Nenin 60 të KPPK-së urdhërohet konfiskimi i armëve të kapura gjatë hetimit.

ARSYETIMI

Historiku procedural

Me 31 korrik 2007, është ngritur në gjykatë aktakuza kundër pesë të akuzuara.

Aktakuza është konfirmuar me datën 17 shtator 2007 me vendimin e gjyqtarit Selman Bogiqi, pas dëgjimit të të akuzuarave dhe avokatëve të tyre mbrojtës gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës.

Gjykimi kundër të akuzuara ka filluar me 22 prill 2008 nga ana e trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë vendor. Pas formaliteteve fillestare dhe leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, ka filluar marrja në pyetje e të akuzuarve.

Gjykimi është shtyer për datën 15 maj 2008 dhe më pas për datën 29 maj, 24 qershor, 11 shtator, 8 tetor dhe 18 nëntor 2008.

Sipas letrës së datës 16.3.2009, kryetari i trupit gjykues, gjyqtari Mehdi Dehari ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që lënda t'i caktohet një trupi gjykues të përbërë nga gjyqtarët ndërkombëtar sipas dispozitave të ligjit për kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it (nr. 03/L-053).

Pas kërkesës së Kryetari të Gjykatës së Qarkut dhe në pajtim me dispozitat e neneve 3.4, 3.6 dhe 4.3 të Ligjit për Kompetencat, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, znj. Giuliana Civinini ka marrë vendim me datën 3 qershor 2009, duke ia caktuar lëndën një trupi gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it Dragomir Yordanov dhe Francesco Florit. Më vonë Ferid Beslimi, si gjyqtar vendor, është caktuar në lëndë nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut, z. Anton Nokaj.

Gjykimi ka rifilluar me 6 tetor 2009. Pas formaliteteve paraprake (duke përfshirë njoftimin për përbërjen e trupit gjykues dhe leximin e aktakuzës) është marrë në pyetje dëshmitari I G.

Në seancat pasuese, dëshmitarët janë marrë në pyetje sipas rendit si në vijim.

Me 26 tetor 2009, dëshmitarët J K, G Z dhe F S.

Me 27 tetor 2009, dëshmitarët A M, D R, S T, V V.

Me 3 nëntor 2009, dëshmitarët A B, B B dhe F H.

Me 4 nëntor 2009, ka filluar marrja në pyetje e të akuzuarve Agim Hoti, Mentor Qela.

Me 11 nëntor 2009, marrja në pyetje e të akuzuarve ka vazhduar me të pandehurit e mbetur.

Gjykata ka dëgjuar fjalën përfundimtare të prokurorit, avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarve me datën 19 nëntor 2009.

Përfundimisht, me 20 nëntor 2009, trupi gjykues ka shpallur aktgjykimin.

Të gjeturat ligjore dhe faktike.

Në fund të gjykimit, akuzat në lidhje me të akuzuarit Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahiu janë konfirmuar ndërsa akuzat kundër Agron Haradinajt dhe A N janë hedhur poshtë për arsye të ndryshme.

Akuzat kryesore kundër të pandehurave janë pikat e aktakuzës për tentim vrasje të Anton Berishës dhe të atyre që po udhëtonin më të me 28 shkurt dhe me 12 prill 2007. Pikat tjera të aktakuzës kanë të bëjnë kapje e armeve të përdoruar gjatë sulmeve apo të zbuluara gjatë bastisjeve të shtëpisë të shfrytëzuar nga Mentor Qela dhe Agim Hoti.

Në dy pikat kryesore të aktakuzës që kanë të bëjnë me tentim vrasje, provat e mbledhura kundër Agim Hotit, Mentor Qeles dhe Driton Spahiut (të akuzuar vetëm për ngjarjen e dytë) janë kolosale dhe të pakundërshtueshme. Ato përbëhen nga provat dëshmuese, nga raportet policore dhe ekspertiza teknik (analiza e gjurmëve të gishtërinjve; raportet nga vendi i ngjarjes; ekspertiza balistike) me vërtetimin e pohimeve të bërë nga të akuzuarit e njëjtë Hoti, Qela dhe Spahiu.

Hetimi kundër të akuzuarve si për ngjarjen e 28 shkurtit 2007 ashtu edhe për sulmin e 12 prillit 2007 kanë filluar me arrestimin e tre të akuzuarve Hoti, Qela dhe Spahiu në afërsi të vendit të ngjarjes së sulmit të dytë dhe janë shtrirë me verifikimin e pranisë së ndonjërit prej të arrestuarave në vendin e ngjarjes së tentim vrasjes së parë.

Në fakt, nga dosjet e lëndës dhe nga marrja në pyetje e dëshmitarëve në gjykatë, duket se hetimi për sulmin e 28 shkurtit 2007 nuk ka sjellë ndonjë rezultat domethënës derisa është bërë e mundur që fotografitë e tre të arrestuarave me 11 prill 2007 t'ju tregoheshin dëshmitarëve dhe të dëmtuarve të sulmit të parë. Para ngritjes së kësaj mundësie, hetimi nuk ka qenë me fat, dhe përkundër qasjes gjithëpërfshirëse hetimore dhe veprimeve të shumta të ndërmarra nga njësia kompetente policore, hetimi nuk kishte dhënë rezultate të rëndësishme.

Prandaj, për arsye praktike, është menduar se i njëjti rregull duhet të ndiqet në hartimin e këtij vendimi, pasi që elementet më relevante dëshmuese kundër tre të akuzuarve të përmendur (Hotit, Qeles dhe Spahiut) vijnë nga ngjarja e 12 prillit 2007.

Le ta shqyrtojmë sulmin që ka ndodhur në pasditen e datës 12 prill 2007 dhe të shikojmë se cilat fakte janë vërtetuar në lidhje më të.

Trupi gjykues beson se nuk është e nevojshme që të bëhet një përshkrim i gjerë i fakteve të cilat kanë ndodhur atë pasdite, pasi që ato kryesisht janë të pakundërshtueshme. Prandaj, kjo mund të jetë konfuze dhe mbase edhe çorientuese për të shpenzuar faqe të tëra për rindërtimin e fakteve që s'do qonin shumë peshë. Veç kësaj, më mirë do të ishte të koncentrohemi në aspektet me kontroverse dhe në mospërputhjet ndërmjet versionit të prokurorit dhe versioneve të avokatëve mbrojtës.

Sulmi që ka ndodhur me datën 12 prill 2007 në rrugën automobilistike Prishtinë – Pejë, në fshatin Gjergjicë, komuna e Drenasit, është përshkruar në detaje nga objektivi i qartë i sulmit (z. A B) dhe nga pjesëtarët e njësisë për mbrojtje të afërt që e kanë shoqëruar atë në atë kohë (I G, G Z, Fatos Sylai, A M dhe D R). Përshkrimet e tyre mundësojnë një rindërtim të plotë të ngjarjes. Sulmi në konvoin e dy veturave është kryer nga një lokacion që gjendej mbi rrugën nëpër të cilën po kalonin automjetet. Gjatë sulmit është hedhur një granatë dore e cila nuk ka goditur ndonjë veturë por ka krijuar një krater në rrugë dhe ka lëkundur njërën nga dy automjetet (në të cilën po transportohej z. B). Brenda një kohë të shkurtër dy raketa janë lansuar nga i njëjti pozicion, njëra nga të cilat e ka goditur veturën e parë të konvoit dhe e ka shpuar mbulesën e motorit të automjetit, duke përfunduar trajektoren e saj ndërmjet motorit të veturës dhe këmbës së vozitësit, dhe duke i shkakuar atij lëndimet e përshkruara raportin mjekësor në dosje të lëndës. Asnjëra nga dy raketat nuk ka eksploduar.

Provat tjera janë siguruar sipas raportit të piroteknikës dhe veprimeve hetimore të kryera në vendin e ngjarjes në ditën e ngjarjes dhe të nesërmen. Hetuesit kanë qenë në gjendje të gjejnë lokacionin e saktë nga i cili janë lansuar predhat dhe është hedhur granat e dorës, t'i përshkruajnë ato me kujdes, kanë gjetur lansuesit e raketave të përdorur gjatë sulmit,

kanë përshkruar me kujdes kraterin e krijuar nga eksplozimi i granatës së dorës dhe kanë lokalizuar projektilin që ka goditur asfaltin dhe është flakur tutje.

Të gjitha këto veprime të ndërmarra nga hetuesit janë në raportin e futur në dosjen e lëndës që është në dispozicion të gjykatës, të shoqëruar me një numër të madh fotografish të një kualiteti të shkëlqyer të vendit të ngjarjes, të cilat paraqesin çdo detaj të mundshëm.

Ky veprim teknik përputhet plotësisht me përshkrimin e fakteve të paraqitura nga dëshmitarët, kështu që ndonjë kontestim rreth modalitetit të sulmit vështirë mund të besohet se mund të ngritët ndonjëherë.

Është e vërtetë se as z. B e as ndonjëri nga policët që e shoqëronin atë nuk kanë identifikuar ndonjërin nga sulmuesit të asaj dite. Sa i përket pozicionit të sulmuesve në momentin e sulmit dhe rrethanave imponuese në të cilat ata janë gjendur, dëshmitarët nuk kanë qenë në gjendje të vërejnë ndonjë lëvizje.

Megjithatë, identiteti i sulmuesve është zbuluar pak kohë pas sulmit.

Kërkimi i nxitur nga veprimi kriminal ka qenë menjëherë frytdhënës dhe tre të akuzuarit Mentor Qela, Agim Hoti dhe Driton Spahiu janë gjetur së shpejti.

Çfarë i ndërlihd këta tre me sulmin? Çfarë provash ka trupi gjykues se këta tre në kohën e arrestimit të tyre po iknin ose jo nga vendin i ngjarje, për shembull, thjeshtë po shëtisnin përreth?

Argumentet në vijim japin përgjigje në pyetje e ngritur më lartë dhe, sipas mendimi të trupit gjykues, ato arsyetojnë në mënyrë të pakontestueshme përgjegjësinë penale të tre të akuzuarave Mentor Qeles, Agim Hotit dhe Driton Spahiut për sulm kundër Anton Berishës dhe pjesëtarëve të njësisë së tij përcjellëse me 12 prill 2007.

Këto argumente nuk kanë për qëllim të jenë sipas rendit të rëndësisë së tyre apo sipas rendin logjik apo kronologjik (parametrat të cilët nuk mund të ekzistojnë ne mesin e argumenteve heterogjene).

1) Pranimi i veprës nga ana e Agim Hotit dhe dy të akuzuarve tjerë.

Siç dihet gjatë zhvillimit të gjykimit Agim Hoti ka pranuar kryerjen e sulmit ndaj Anton Berishës me 12 prill 2007.

Kjo është e dokumentuar mirë nga procesverbali i seancës gjyqësore të mbajtur në korrik 2009 (për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të Hotit lidhur me mbajtjen në paraburgim) ku i akuzuari ka pranuar fajësinë e tij.

Pastaj Agim Hoti ka pranuar pjesërisht fajësinë me 6 tetor 2009 gjatë seancës së parë gjyqësore.¹

¹ Procesverbali nga seanca e datës 6.10.09:

Kryetarit i trupit gjykues i drejtohet të pandehurit: Agim Hoti, a e kuptoni aktakuzën?

Gjatë marrjes së tij në pyetje me 4 nëntor 2009, i akuzuari me tej ka konfirmuar përgjegjësinë e tij për sulmin e kryer me 12 prill 2007. Ai ka pranuar se kishte qëlluar në drejtim të automjetit të Anton Berishës nga inati dhe zemërimit për shkak të shpërdorimit të supozuar të parave publik nga B.

Përfundimisht, i akuzuari Hoti ka përsëritur pranimin e njëjtë të përgjegjësisë gjatë mbajtjes së seancës gjyqësore me 19.11.2009, në fund të fjalës përfundimtare.

Këto pranime të përsëritura për lansimin e raketave kundër konvoit të Anton Berishës me 12 prill 2007 gjithmonë kanë qenë të ndërlidhura, në versione të ndryshme të paraqitura gjatë gjykimit, me përjashtimin e përgjegjësisë së Mentor Qele dhe Driton Spahiut. Kur ka pranuar fajësinë e tij para gjyqtarëve, Agim Hoti ka folur për vete dhe vetëm për vete.²

Dhe jo vetëm kaq, Agim Hoti gjithashtu ka kontestuar çdo pohim të përgjegjësisë së tij për kapjen e armeve të përdoruar gjatë sulmit, duke thënë se i kishte gjetur ato rastësisht, një javë para sulmit, kur është dashur të shkojë 'në mal' (shprehje e përdorur gjatë seancës së datës 4.11.09) derisa po udhëtonte nga Peja për në Prishtinë, për një pushim të rehatshëm.

Trupi gjykues nuk mendon se është e nevojshme të harxhohet shumë kohë për të sqaruar absurditetin e versionit të treguar nga i akuzuari. Kontradiktat e shumëfishta, mospërputhja e qartë janë të dukshme: ato madje as që meritojnë sqarim sepse ato janë të qarta për çdo individ me nivel minimal intelektual.

Të pritët të besohet se kur dikush thotë se ka gjetur armët rastësisht dhe se ka vendosur t'i përdor ato sepse kishte parë rastësisht veturën e z. B duke kaluar rrugës kryesore, është vetëm një tregues i një sofistikimi të rrallë intelektual nga ana e të akuzuarit. Është e turpshme se si i akuzuari, gjatë mbajtjes së gjykimit, ka përsëritur këtë absurditet kundrejt

Agim Hoti: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Si deklarojeni?

Agim Hoti: Jam pjesërisht fajtor.

Kryetari i trupit gjykues: Tri akuza janë lexuar lidhur me ju. Dy lidhur me dy ngjarjet e tentim vrasjes dhe një në lidhje me konfiskimin e një arme dhe rakete të cilat i kishit në posedim të paautorizuar. A deklarojeni fajtor për këtë? ?

Agim Hoti: E pranoj fajësinë për atë që ka ndodhur me 12 prill por jo edhe posedimin e armëve. ato i kam gjetur aty.

Kryetari i trupit gjykues: Pra ju nuk pranoni fajësinë për ngjarjen në fillim të shkurtit 2007?

Agim Hoti: Absolutisht i pafajshëm.

² Procesverbalë nga seanca e datës 4.11.09:

Prokurori publik: Ju po thoni se keni qëlluar; me çfarë arme?

Agim Hoti: Zollë.

Prokurori publik: Më kënd keni qenë në atë moment?

Agim Hoti: Unë jam Agimi, kam qenë me vetën time.

krejt asaj që është logjike; dhe është për tu habitur se si avokati i tij mbrojtës nuk i ka sugjeruar Agim Hotit se do të ishte sikur të mos fliste fare, sesa të fliste gjepura..

Gjatë fazës së hetimeve, i akuzuari i njëjtë ka dhënë një version më të kuptueshëm dhe më të besueshëm lidhur me ngjarjen e 12 prillit 2007. Duke i lënë anash për momentin deklaratat e dhëna në polici (më vonë të ndryshuara nga i dyshuari pasi që kishte qenë i detyruar), ne koncentrohemi në deklaratën që i është dhënë prokurorit me 4 maj 2007, të shfrytëzuar nga prokurori gjatë marrjen në pyetje të Agim Hotit në gjykatë me 4.11.09 për kontestimet sipas nenit 372.2 të KPPK-së.

Në atë deklaratë, i akuzuari kishte përmendur pjesëmarrjen e Mentor Qeles dhe Driton Spahiut në sulmin ndaj Anton Berishës dhe ndaj personave që shoqëronin atë me 12 prill 2007.

Në atë deklaratë, Hoti kishte pranuar të këtë përdorur lansuesin e raketave, duke shtuar se Mentor Qela kishte qëlluar me raketën e dytë menjëherë pas tij, ndërsa, Driton Spahi u kishte hedhur granatën e dorës. Gjatë mbajtjes së seancës me 4.11.2009, i përballur me kontradiktat, i akuzuari Agim Hoti ka bërë përpjekje që ti arsyetoj ato duke pohuar *“Nëse kam thënë kështu para prokurori publik, atëherë është e mundshme të jetë e vërtetë. Dëshiroj t’ia përkujtojë prokurorit publik se në atë kohë nuk ndihesha mirë dhe kisha probleme psikologjike dhe një muaj me vonë kur i kam hequr rrobat kam vërejtur se isha tërë shenja dhe kisha një gungë në kokë, prandaj është mundshme se ajo që kam thënë ka qenë e vërtetë”*.

Tani, cili duhet të jetë versioni i besueshëm dhe në ç’menyrë gjykata duhet t’i shfrytëzojë deklaratat e mëhershme në vlerësimin e provave? A mjafton të thuhet se vetëm deklaratat e dhënë në gjykatë para trupit gjykues dhe të dhënë së fundi, mund të jenë të besueshme, përkundër konfliktit të tyre me logjikën?

Nuk ekziston ndonjë arsye që mbështet këtë konkludim. Deklarata e dhënë nga Agim Hoti para prokurorit gjatë hetimit është shfrytëzuar me qëllim të rifreskimit të kujtesës së të akuzuarit në përputhje me nenin 372.2 të KPPK-së. Si pasojë, deklarata tani mund të shfrytëzohen si provë, pasi që ajo konsiderohet nga trupi gjykues si më e përputhshme dhe më e besueshme se deklaratat e dhënë në gjykatë nga i njëjti gjatë marrjes në pyetje. Së fundi, i akuzuari i njëjtë Hoti, gjatë mbajtjes së seancës të datës 4 nëntor 2009, duke komentuar deklaratën e tij të mëhershme të dhënë para prokurorit ka konkluduar, siç është cekur më lartë: *“Nëse kam thënë kështu para prokurori publik, atëherë është e mundshme të jetë e vërtetë”*.

Siç tregohet nga raporti policor për ekzaminimin e vendit të ngjarjes dhe nga përshkrimi i sulmit nga ana dëshmitarëve, sulmi nuk ka qenë një veprim i një individi të vetëm. Tri projekte (një granatë dore dhe dy raketa) janë lansuar nga një distancë e shkurtër dhe terreni ka qenë i përgatitur që përpara. Duke marrë parasysh shpejtësinë e veturave në momentin e sulmit dhe kohën e shkurtër në dispozicion për të kryer sulmin, më padyshim mund të konkludohet se tre të akuzuarit është dashur të planifikojmë më parë sulmin dhe të koordinojnë më kujdes zbatimin e planit në mes vete. Përveç kësaj, tre të akuzuarit janë gjetur së bashku, njëri nga ta ende në posedim të dy granatave të dorës.

E gjithë kjo shpie në konkludimin e vetëm të mundshëm se të tre bashkëkryerësit kanë vepruar së bashku, si një grup i vetëm dhe i koordinuar mirë, nën drejtimin e një individi të vetëm. Versioni që fillimisht është dhënë në gjykatë nga Agim Hoti se kishte vepruar si individ i shtyrë nga dëshpërimi i momentit kundër z. Berishës, nuk konfirmohet nga faktet e lëndës dhe prandaj duhet të hedhet poshtë si i pavërtetë, si një përpikëj e vonuar dhe patetike për ta përqendruar në vetvete, dhe vetëm në vetvete, përgjegjësinë për krimin e kryer.

Sa i përket arsyeve për një sjellje të tillë, do të jetë e nevojshme të kthehemi në një fazë të mëvonshme. Tani për tani, mjafton të kihet parasysh se liria që i është dhënë të akuzuarit që të flasë çfarëdo që ai apo ajo mendon se është e duhur për mbrojtjen e tij/saj, pavarësisht se sa e pabesueshme është ajo që thotë, nuk nënkupton se do t'i besohet atij/asaj. Përkundrazi, këmbëngulja e të akuzuarit Hoti në pohimin e një versioni fantastik nuk shkon në favor të tij e as nuk mund të ketë leverdi të plotë nga pranimi i tij i pjesshëm i fajësisë.

Gjatë gjykimit, dy të akuzuarit tjerë Mentor Qela dhe Driton Spahiu kanë refuzuar të pranojnë ndonjë përgjegjësi për sulmin ndaj konvoit të z. Berishës me 12 prill 2007. Gjithashtu, kur janë marrë në pyetje nga prokurori me 25 përkatësisht 4 maj, ata kanë dhënë një version të ngjarjeve të asaj dite që nuk përputhet me versionin e Agim Hotit.

Gjatë fazës së hetimit, Mentor Qela ka konfirmuar para prokurorit se me datën 12 prill 2007, që të tretë kanë hipur në autobus për Pejë dhe pastaj kanë vendosur të zbresin para se të arrinin në qytetin e Pejës; ai ka konfirmuar të jetë 'futur në mal' dhe të ketë ecur nëpër kodrinën anash rrugës kryesore Prishtinë-Pejë. Por ai ka refuzuar akuzat për pjesëmarrje në të shtëna dhe pastaj ikjen nga vendin i ngjarjes; ai ka pranuar se Hoti ka përmendur prezencën e armëve në atë zonë por ka kontestuar deklaratën e Hotin në këtë pikë, dmth. se ata kishin folur rreth zbulimit të armëve në pyll një javë para sulmit dhe se ata më të vërtetë kishin planifikuar sulmin.

Gjatë marrjes në pyetje në gjykatë si dhe para prokurorit, Driton Spahiu ka kundërshtuar ndonjë përfshirje në krim, duke thënë se ai thjesht po shoqëronte Qelen dhe Hotin për në Pejë, pa pyetur shumë; ai ka thënë se kishte pritur për dy shokët e tij në rrugën kryesore dhe se ishte arrestuar pak pasi që kishte filluar të hynte në pyll.

Dy të akuzuarit Qela dhe Spahiu nuk kanë bërë përpjekje të arsyetojnë versionin e Hotit, kur ju është lexuar gjatë marrjes së tyre në pyetje si në gjykatë ashtu edhe para prokurorit, dhe as që janë përpjekur të tregojnë se pse kishin filluar të ecnin nëpër kodrina kur fillimisht kishin planifikuar të shkojnë në Pejë. Versioni i tyre i të qenit në një vend pa asnjë arsye specifike është i pakuptimtë dhe jo i kënaqshëm.

Mentor Qela, Agim Hoti dhe Driton Spahiu gjithashtu kanë dhënë deklaratat e tyre në polici. Deklaratat e tre të akuzuarave Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahiu të dhënë në polici në ditën e arrestimi të tyre në prani të avokatëve të tyre mbrojtës mund të gjenden në dosjen e lëndës.

Këto deklarata janë vetë-akuzuese; ato paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të sulmit në dëm të Anton Berishës dhe personave që e shoqëronin me datën 12 prill 2007 si dhe të sulmit të kryer me 28 shkurt 2007.

Siç dihet, avokatë mbrojtës të të gjithë të akuzuarve (duke përfshirë z. Millakun, avokat mbrojtës i Agron Haradinajt) kanë kontestuar pranueshmërinë e deklaratave të tilla, me arsyetimin se deklaratat e Hotit, Qeles dhe Spahiut janë marrë me detyrim me 13 prill 2007 pas rrahjeve të ashpra dhe të shumta të tre të akuzuarve.

Sa i përket këtyre pretendimeve, nuk ekziston ndonjë konfirmim në dosje të lëndës. Për hir të plotësisht, gjykata ka urdhëruar marrjen e dokumenteve rreth pranimin të të akuzuarit Agrom Hoti në qendrën e parë të paraburgimit në të cilën ai është sjellë pas arrestimit të tij (Prizren) por raporti mjekësor nga vizita mjekësore gjatë pranimin nuk konfirmon fare shenja të rrahjeve në shkallë të gjerë, siç pretendohet gjatë gjykimit nga vetë i akuzuari.

Në anën tjetër, në fund të seancës së datës 3 nëntor 2009, trupi gjykues ka përjashtuar mundësinë që t'i dëgjojë si dëshmitarë znj. Fikrije K dhe znj. Femije Gashi Bytyqi, avokate mbrojtëse të Qeles, respektivisht Hotit, gjatë marrjes në pyetje lidhur me modalitetet e marrjes në pyetje.

Në këtë mënyrë konfirmohet baza faktike dhe ligjore e këtij vendimi.

Është vështirë të mohohet se deklaratat e hollësishme vetë-akuzuese nuk paraqesin një element të fuqishëm të akuzës kundër individëve që kanë dhënë këto deklarata.

Ato nuk mund të hedhen thjesht poshtë në bazë të një argumenti të padëshmuar se kanë qenë të detyruar.

Marrja e deklaratës nën detyrim është një akt i ulët, që paraqet diçka shumë të afërt me torturën nga ana e oficerit që krye atë. Ajo duhet të dëshmohet dhe jo vetë të pretendohet. Si është e mundur që shkeljet e supozuara të kryera nga policia në kohën e arrestimi të Qeles, Hotit dhe Spahiut nuk janë përmendur në deklaratat e nënshkruara nga të akuzuarit dhe nga avokatët e tyre mbrojtës apo në procesverbalin nga seancës e datës 15 prill 2007 para gjyqtarit të procedurës paraprake Bedri K?

Pjesëmarrësit në seancën para gjyqtarit të procedurës paraprake me 15 prill 2007 (tri ditë pas arrestimit të tyre) kanë pasur mundësi që të flasin pa kufizime; të gjitha komentet dhe përgjigjet e dhëna nga palët janë shënuar në procesverbal. Pasusi i vetëm që aludon në çështjen ngritur tani mund të gjendet në intervenimet e Mentor Qeles. Kur i akuzuari është pyetur nëse e konfirmon deklaratën e dhënë më herët, ai ka refuzuar ta bëjë këtë, sepse ai ka thënë se ato janë dhënë nën presion. Asnjë nga të pranishmit tjerë në atë seancë nuk kanë pasur preokupime të ngjashme, qoftë të akuzuarit qoftë avokatët e tyre mbrojtës. Përkundrazi, Agim Hoti dhe Driton Spahiut kanë konfirmuar deklaratat e dhënë para dy ditëve dhe po ashtu kanë pasur mundësi të specifikojnë nëse jo gjithçka ishte e saktë (Agim Hoti: *“E pranoj në tërësi deklaratën e dhënë në organin prokurorial por jo gjithçka”*, Driton Spahiut: *“Ajo që ju kam deklaruar autoriteteve prokuroriale është e vërtetë por disa informata janë të pavërteta”*); sidoqoftë, ata nuk kanë përmendur dhunën apo presionin ndaj tyre.

Pse të mos përmendej, se paku tek avokatët, dhuna të cilën pretendojnë ta kenë pësuar? Pse mos ta mbrojnë vetveten nëse kanë qenë të detyruar? Pse t'i konfirmojnë në prani të avokatëve dhe gjyqtarit deklaratat e dhënë më parë?

Mbrojtja e të akuzuarve Qela, Spahiu dhe Hoti se kanë qenë të keqtrajtuar dhe se kanë pranuar nën detyrim është e vonuar dhe nuk është vërtetuar nga ndonjë element tjetër i rëndësishëm. Do të ishte gabim që t'i jepej besueshmëri mbrojtës së vonuar të Qeles dhe Spahiut kundrejt fjalëve të njëjta të të bashkakuzuarit Hoti (i cili ka pohuar pranimin).

Si përfundim, trupi gjykues konstaton se deklaratat e dhëna nga të akuzuarit me datën 13 prill 2007 janë të pranueshme në prova..

Pranimet e të akuzuarave janë të besueshme dhe vështirë mund të kundërshtohen. Versionet e dhëna nga tre të akuzuarit lidhur me ngjarjen e dytë përputhen mjaft mirë ndërmjet tyre dhe me faktet e paraqitura në raportin nga vendi i ngjarjes si dhe me dëshmitë e dëshmitarëve, prandaj është e papërfytyrueshme se ato janë nxjerrë dhe janë sugjeruar nga policët të cilët po merrnin në pyetje të dyshuarit.

Shumë rrethana relevante kanë mundur të jenë të panjohura për hetuesit në kohën e marrjes në pyetje.

Për shembull, përshkrimi i lansimit të projektilëve dhe granatës së dorës. Apo rrethanat që lidhen me largimin nga vendi i ngjarjes. Apo sa i përket gjurmëve të gishtërinjve të Spahiut të gjetura në njërin nga lansuesit e raketave, që konfirmojnë se i akuzuari e ka përdorur armën, qoftë edhe vetëm për ta pastruar atë, para kryerjes së sulmit, siç Sahiu i referohet deklaratës së tij fillestare.

Pjesët e pranimeve nuk mund të anulohen vetëm me anë të pretendimeve të pabazuar për rrahje apo si pasojë e ndryshimit të versionit nga të akuzuarit. Për të arritur kulmin e gjithë kësaj, pretendimi i të akuzuarve Mentor Qela dhe Agim Hoti se emri i Agron Haradinajt është “nxjerrë” nga policët e njëjtë gjatë rrahjeve, është qesharak: si kanë mundur policët të dinë në kohën e arrestimi të tyre se Agron Haradinajt ishte shok i tre të dyshuarve? Pse duhej që policia të nxirrte emrin e Agron Haradinajt, një njëri i zakonshëm pa të kaluar kriminale? Kur ata kishin tre të dyshuar, pse do të rrezikonin që ta njollosnin hetimin, duke shpikur emrin e Haradinajt?

Megjithatë, deklaratat e Mentor Qeles dhe Agim Hotit nuk mjaftojë për të vërtetuar përgjegjësinë penale të Agron Haradinajt. Pavarësisht se sa precize dhe të përputhshme kanë qenë deklaratat e dhëna nga Agim Hoti dhe (kryesisht) nga Mentor Qela rreth rolit të tij, është fakt se përgjegjësia penale e të akuzuarit nuk mund të bazohet ekskluzivisht vetëm në to.

I vetmi element i vërtetimit të akuzës kundër Agron Haradinajt është paraqitur me anë të një shkëmbimi të një mesazhi ndërmjet telefonit nr. 044 586 596 (telefoni i Qeles) dhe telefonit të Agron Haradinajt nr. 044 115 765 me 6 prill 2007 në ora 17.33; kontesti i mesazhit dhe shfaqësimi i Qeles ndaj shokut të tij Haradinajt, është shumë i përgjithshëm dhe i paqartë për t'ju referuar sulmit të dështuar të datës 28 shkurt 2007. Veç kësaj, nuk

është e qartë se pse kjo keqardhje do të dërgohej pas me tepër se një muaj pas tentimit të dështuar.

Sinqerisht, kjo është shumë e pakët në mungesë të diçkaje tjetër. Gjykimi nuk ka lejuar zbulimin e fakteve tjera që tregojnë lidhjen ndërmjet krimit dhe të akuzuarit Haradinaj.

Duke marrë parasysh këto që u cekën më lartë, do të zbatohet dispozita e nenin e 157.2 të KPPK-së. Gjykata nuk mund t'i bazojë konstatimet e saj për fajësinë e një të akuzuari vetëm në deklaratat e dhëna apo ato më bindëse që i akuzuari i jep para autoriteteve hetuese. Kjo normë dëshmon për një lloj mosbesimi nga ana e ligjvënësit në deklaratat e dhëna në polici apo para prokurorit, përkundër pranisë së avokatëve mbrojtës. Kjo dispozite parashih që provat kryesore kundër një të akuzuari duhet të mblidhen nga burimet tjera përveç atyre nga vetë i pandehuri. Dhe kjo rregull vlen edhe në rastin e dy apo më tepër deklaratave të përputhshme nga më shumë se një i pandehur.

S'ka dyshim se në rastin aktual, në lidhje me Agron Haradinajn, nuk është plotësuar standardi i kërkuar. Elementi i vetëm i jashtëm i konfirmimit të deklaratave akuzuese të Mentor Qeles dhe Agim Hotit është paraqitur një shkëmbim i mesazhit telefonik ndërmjet Qeles dhe Haradinajt disa ditë para ngjarës së dytë, që qartazi nuk është e mjaftueshme.

2) Prezenca e Agim Hotit, Mentor Qeles dhe Driton Spahiut afër vendit të ngjarjes;

Rrethana se tre të akuzuarit po largoheshin nga vendi i ngjarjes dhe ishin kapur në një distancë të caktuar nga njëri tjetri konfirmon se ata po iknin nga vendi i ngjarjes. Ekziston një koincidenca ndërmjet distancës nga vendi i ngjarjes (rreth 4 km)³ dhe nga koha e arrestimit të tyre (40-50 minuta me vonë).

Arsyetimet e dhëna nga tre të akuzuarit lidhur me prezencën e tyre në atë vend janë të ndryshme.

Agim Hoti, i cili ka konfirmuar kryerjen e krimit, ka thënë se pasi që kishte shirë me një lansues raketash, ai ishte bashkuar me dy shokët e tij të cilët po e prisnin në maje të kodrës.

Gjatë marrjes në pyetje, derisa por përjashtonte çdo përgjegjësi për kryerjen e krimit, Mentor Qela ka thënë: *“Diku gjatë rrugës ky plan (për të shkuar në Pejë me autobus – shënim nga autori) ka ndryshuar dhe ne kemi vazhduar të shkojmë diku tjetër. Më kujtohet se jemi ndaluar në një fshat që kishte drunj pishe në anën e djathtë dhe pastaj ne thjesht kemi vazhduar rrugën malore... këmbë nëpër pyjet dhe rrugën e fshatit.*

Prokurori publik: Përse?

Mentor Qela: *Për të shkuar tek shtëpia e Agimit. Vendimi nuk ishte shumë i definuar, por ne kemi vendosur aty që të shkojmë tek shtëpia e tij; ose të shkojmë në Prishtinë ose të shkojmë tek shtëpia e Agimit. Kemi vazhduar të ecim, unë nuk e njoh terrenin, derisa kemi hasur në personat të cilët thanë se ishin policë.*

As për udhëtimin në Pejë nuk është dhënë ndonjë motiv specifik e as për devijimin e rrugës. Nuk ekziston ndonjë arsyetim rreth mospërputhjes së versionit të tij me fjalët e Hotit.

³ Kjo rrethanë është konfirmuar si nga Driton Spahiut gjatë marrjes së tij në pyetje ashtu edhe nga dëshmitarët Bytyqi dhe V V.

Ndërsa Driton Spahiu ka thënë së ju ishte bashkangjitur vetëm për qejf, ndonëse gjithashtu arsyeja kryesore për tu takuar më të tjerët ka qenë nevoja e tij për punë dhe para. Atij i kujtohet: *“Kemi shkuar në Pejë për kafe, në fillim kam refuzuar të shkojë pasi që doja të shkoja për një shëtitje, nuk kisha para për kafe por kam shkuar me ta dhe kemi hipur në autobus afër urës për në Mitrovicë. Gjatë rrugës për në Pejë ata kanë thënë të ndalen në një vend, emrin e të cilit nuk e di. Kemi zbritur aty. Aty kishte një autolarje dhe disa dyqane, dy të tjerët u nisën një rrugë dhe më thanë që t’i prisja aty”*.

A është e besueshme se Spahiu është ftuar që të shkojë në Pejë për kafe dhe pastaj është lënë i vetëm në rrugë? A është e besueshme se Agim Hoti dhe Qela e ftojnë shokun e tyre për t’i shoqëruar dhe pastaj kërkojnë nga ai që të pres derisa ata shkojnë për ta kryer sulmin me lansues raketash dhe granatë dore? Sa është ky version i përputhshëm me praninë e gjurmëve të gishtërinjve të Spahiut në armën e përdorur për të qëlluar në veturën e Anton Berishës?

Pamundësia për të gjetur një përgjigje logjike në të gjitha këto pyetje tregon se rrëfimi i fakteve i bërë nga Spahiu nuk është i besueshëm dhe është një produkt i thjeshtë i imagjinatës së të akuzuarit.

Përkundrazi, siç është cekur më parë, modaliteti për ndjekjen dhe zbulimin e tre të akuzuarve disa kilometra larg vendit të ngjarjes pas më pak se gjysmë ore pasi ishte kryer krimi, është në përputhje me prezencën e të akuzuarve në vendin e ngjarjes.

3) Gjetja e granatës së dorës në kohë e arrestimit dhe gjurmët e gishtërinjve të Spahiut në lansuesin e raketave.

Driton Spahiu është gjetur në mbajtje të dy granatave (njërën me vete dhe tjetrën në tokë afër tij) në momentin e arrestimit të tij .

Raporti i piroteknikës ka nxjerrë në pah praninë e gjurmëve të gishtërinjve të Driton Spahiut në njërin nga lansuesit e raketave të marrë nga vendi i ngjarjes. Në mënyrë specifike, sa i përket kësaj pike, raporti i ekzaminimit kriminologjik i përgatitur nga ekspertja Ganimete Osmani pas ekzaminimit të armëve i kryer me 8 maj 2007 ka vërtetuar se njëri nga lansuesit e raketave (i identifikuar si EX#3) kishte një gjurmë të vijave papilare të cilat janë përputhur me ato të gishtit të mesëm të dorës së djathtë të Driton Spahiut. Rezultatet e analizave kompjuterike të kryera nga Sistemi AFIS (sistem standard i përdorur në të gjitha vendet e zhvilluara) janë vërtetuar më tej me anë të krahasimit të drejtpërdrejt tradicional të kryer nga operatori, që ka konfirmuar një rezultat pozitiv.

Kjo dëshmon se Driton Spahiu e ka përdorur armën e shfrytëzuar në sulm.

Driton Spahiu nuk ka qenë në gjendje të jap sqarim lidhur me asnjërën rrethanë.

Çfarë tjetër duhet të shtohet?

- - -

Siç u tha, provat e përshkruara deri me tani janë të mjaftueshme për të vërtetuar përgjegjësinë penale të tre të akuzuarave për ngjarjen e dytë, dmth. sulmin kundë veturës së Anton Berishës dhe personave që po e shoqëronin atë derisa për udhëtonin nga Peja për në Prishtinë në pasditen e 12 prillit 2007, por nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar përgjegjësinë penale të Agron Haradinajt për të njëjtën ngjarje.

- - -

Le t'i kthehemi tani ekzaminimit të ngjarje së parë, që ka ardhur si pasojë e sulmit kundër Anton Berishës në fund të shkurtit. Për këtë janë akuzuar Agim Hoti dhe Mentor Qela së bashku me Agron Haradinajn.

Sa për fillim, në lidhje me ngjarjen e 28 shkurtit 2007, Agron Haradinaj gjendet në një situatë edhe më të favorshme, pasi që nuk ekziston ndonjë element përveç fjalëve të Agim Hotit dhe Mentor Qele në deklaratat e tyre të datës 13.4.07.

Pas elementeve të ilustruara më lartë lidhur me pamjaftueshmërinë e këtyre deklaratave për të vërtetuar përgjegjësinë penale për këdo përveç të njëjtëve që kanë pranuar fajësinë, është e qartë se përgjegjësia e Haradinajt duhet të përjashtohet pa hezitim.

Përkundrazi, përgjegjësia e Mentor Qeles dhe Agim Hotit edhe për sulmin e parë bazohet në provat e mëposhtme.

1) Pranimi i fajësisë nga dy të akuzuarit..

Siç është vërejtur më lartë, deklaratat e dhëna nga Mentor Qela dhe Agim Hoti në polici me 13 prill 2007 nuk mund të lehen anash thjesht në bazë të një presion të padëshmuar dhe të pretenduar fizik dhe psikologjik që me vonesë është denoncuar në autoritetet prokuroriale.

Nga këto deklarata, nëse gjithashtu kontestohen dhe kundërshtohen në një fazë të mëvonshme, qartazi shfaqet pranimi i fajësisë.

Rrethana se Agim Hoti ka konfirmuar kryerjen e krimit në ngjarjen e dytë por ka mohuar pranimin e të parit, nuk nënkupton thjesht se vetëm versioni i tij i fundit duhet të besohet.

Në të vërtetë, për arsye të panjohura për ne, Agim Hoti ka vendosur të konfirmojë pranimin e fajësisë për sulmin e dytë, në vend të mohimit të provave më rënduese (gjetja e granatës së dorës, gjurmët e gishtërinjve në lansuesin e raketave, pranimin e fajësisë nga bashkëkryerësi) siç ka bërë Mentor Qela dhe Driton Spahiu. A e ka konfirmuar pranimin e fajësisë për shkak të pendimi të vërtetë apo thjesht për strategji, që synon në sigurimin e një trajtimi më të mirë nëse shpallet fajtor?

Më sa duket opsioni i dytë është përgjigja e saktë. Po të kishte qenë motivues i pranimit të fajësisë tij gjendja psikologjike e pendimit, ai do ta përshkruante tërë veprimin me të gjitha rrethanat dhe pjesëmarrësit në ngjaje dhe nuk do ta kufizonte përgjegjësinë e tij si

një akt i rastësishëm, që ka ndodhur nga emocioni i çastit⁴ dhe i shkaktuar nga zbulim i rastësishëm i armëve⁵.

Vendimi i Hotit për të pranuar përgjegjësinë e tij për krimin është një llogaritje: ai e kupton se, duke marrë parasysh provat kundër të akuzuarve lidhur me sulmin e dytë, ai nuk ka ndonjë mundësi reale që të lirohet. Prandaj, më mirë është që të pranojë fajësinë për ngjarjen e dytë, për të marrë dënim me të vogël. Por ai nuk pranon minimumin, dmth. atë që nuk mund ta mohojë, duke përjashtuar përfshirjen e ndokujt tjetër dhe duke ia vënë fajin për ngjarje zbulimit të rastësishëm të armëve.

Nëse kjo është arsyeja që e ka shtyrë Hotin për ta konfirmuar (rumbullakësuar) pranimin e fajësisë për sulmin e dytë, nuk është çudi që Hoti nuk ka konfirmuar pranimin fillestar të fajësisë në lidhje me ngjarje e parë: në atë rast materialet dëshmues nuk kanë qenë të gjitha kundër të akuzuarit.

Por, për shkak se ne e dimë arsyen për ndryshimin e versionit të tij (në lidhje me ngjarje e parë), mund të konkludojmë se në vend të heqjes së besueshmërisë në pranimin fillestar të fajit, ndryshimi i versioni ia shton me tej besueshmërinë.

2) Dëshmitë nga të dëmtuarit dhe J M.

J K i ka identifikuar Mentor Qelen dhe Agim Hoti tsi autorë të sulmit që ka ndodhur me 28 korrik 2007 në rrugën Pejë-Prishtinë në dëm të veturës që ka qenë duke u drejtuar dhe në të cilin po udhëtonte B.

Identifikimi është bërë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga ana e prokurori dhe është përsëritur në gjykatë.

Dëshmitari ka përshkruar ngjarje me një kujtesë të mbrehtë dhe ndjenjë të lartë për detajet. Përshkrimi i tij ka qenë i qartë, logjik dhe i besueshëm; fakti se është përsëritur në të njëjtën mënyrë pas një periudhe disa vjeçare është një element që kontribuon në besueshmërinë e deklaratave të dhëna.

Gjatë marrje së parë në pyetje, menjëherë pas ngjarjes së datës 28.2.2007, nuk ka pasur mundësi që t'i identifikojë të dyshuarit, pasi që hetimi nuk kishte pasur mundësi që të identifikojë ndonjë të dyshuar.

Por, sapo janë arrestuar tre të dyshuarit Hoti, Qela dhe Spahiu, në mesin e prillit 2007, fotografitë e tyre u janë treguar Berishës dhe Kraniqit dhe identifikimi i Qeles dhe Hotit në fakt ishte bërë në atë kohë.

Gjatë seancë së datës 26.10.09, J K i ka identifikuar përsëri dy të pandehurit. Kur është pyetur nga kryetari i trupit gjykues nëse ishte i sigurt ose jo lidhur me identifikimin, dëshmitari është përgjigjur: *“Thashë në fillim se nuk jam i sigurt por mendoj se janë ata”*.

⁴ Procesverbali nga marrja në pyetje, 4 nëntor 2009: *“Nuk e kam kontrolluar vetën”*.

⁵ Procesverbali nga seanca e datës 4 nëntor 2009: *“Unë thjesht jam viktimë e armeve që kam gjetur”*.

I pyetur nga prokurori se cili ka qenë roli specifik i secilit nga të pandehurit që sapo i kishte identifikuar, J K është përgjigjur: *“Mendoj se ky që është ulur afër meje është ai me revole (Mentor Qela) dhe ai prapa mendoj se kishte një pushkë automatike”*.

Ai përsëri është pyetur nga prokurori: *“Gjatë identifikimit para prokurorit ... a keni qenë të sigurt apo keni pasur ndonjë dyshim?”* J K është përgjigjur pa hezitim: *“Në atë kohë kam qenë shumë i sigurt”*.

Identifikimi i bërë në gjykatë nga J K ishte kontestuar në gjykatë, sepse nuk ishte në pajtim me dispozitën e nenit 225 të KPPK-së, i cili parasheh përshkrimin e të dyshuarit dhe disa formalitete tjera, duke përfshirë praninë e individëve tjerë për krahasim.

Kjo pikë ishte vendosur nga trupi gjykues gjatë seancës së njëjtë (faqja 13/14 e procesverbalit të seancës); nuk ka nevojë të përsëritet çfarë është thënë atëherë. Ekziston vetëm një vërejtje se parimi i lirisë së formave të provave lejon procedurën (kontestimore). Siç përcaktohet sipas nenit 152.2 të KPPK-së, provat të cilat mund të sillen para një gjykate nuk janë të kufizuara në format e parapara sipas Kodit. Përkundrazi, gjykata *“mund të pranojë dhe shqyrtojë çdo provë të pranueshme që ... është relevante dhe ka vlerë dëshmuese dhe ka kompetencë që lirshëm t’i vlerësojë të gjitha provat e paraqitura me qëllim të vlerësimit të rëndësisë apo pranimit të tyre”*. Më një të drejtë të gjerë të lirisë së veprimit nga ana e gjykatës në vlerësimin provave, nuk ka arsye të besohet se provat janë vetëm rezultat i disa mekanizmave të paraparë në kod për nxjerrjen e tyre. Përveç nëse ndalohet rreptësisht dhe janë shprehimisht të papranueshme (neni 153 i KPPK-së) çdo element i dobishëm që mund të sjellë gjykatën më afër të vërtetës është i lejuar.

Pastaj, pse të përjashtohet apo të kufizohet (sipas një kërkesë mjaftë të çuditshme, të bërë nga avokati, që të pandehurit të përzihem me publikun: faqja 14 e procesverbalit) mundësia që gjyqtari të ketë një përshtypje të menjëhershme rreth kapaciteti të dëshmitarit për ta bërë identifikimin, me lehtësi të madhe apo më të vogël, personin të cilin e kishte parë në kohën e sulmit?

Dhe pasi që po diskutojmë rreth identifikimit të bërë nga J K gjatë gjykimit dhe gjatë hetimit, trupi gjykues nuk mund t’i shmanget përmendjes së kërkesë së avokatëve mbrojtës të të pandehurve të cilët janë identifikuar, për caktimin e një oftamologu si dëshmitar ekspert dhe për të dëshmuar rreth mundësisë që individi i cili udhëton në veturë me shpejtësi 120 km/h, mund ta shoh fytyrën e një person që qëndrona skaj rrugës. Një ekspertizë e tillë nuk është e nevojshme. Trupi gjykues, i përbërë nga individë me përvojë, është në gjendje që t’i vlerësojë të gjitha faktet dhe e sheh si shumë të mundshme që imazhi i fytyrës së agresorit mbetet i ngulitur në kujtesën e vozitësit dhe pasagjerit të veturës që lëviz sipas shpejtësisë së përmendur. Kjo korrespondon me përvojën e zakonshme se në më pak se një sekondë mund të formohen imazhe të qarta në sytë dhe trurin e shikuesit, sidomos nëse ato ndërlidhen me rrethanat dramatike.

Gjatë marrjes në pyetje të J Kt, avokatët mbrojtës Bekim Veliqi, Isa Osdautaj dhe Haxhi Millaku kanë shtruar një numër të madh pyetjesh me qëllim të testimi të besueshmërisë së dëshmitarit dhe në përpjekje për të gjetur mospërputhjet e mundshme në përshkrimin e

fakteve nga ana e tij. Këto përpjekje kanë qenë jetëshkurtër dhe nuk kanë sjellë rezultatet e pritura nga avokatët mbrojtës. Rrëfimi nga ana e dëshmitarit J K ka qenë i thjeshtë por i qartë; ai nuk qenë në mënyrë substanciale i ndryshëm nga deklaratat e dhëna në polici dhe para prokurorit. Identifikimi i të akuzuarit Qela dhe Hoti para prokurorit është bërë në pajtim me Kodin e Procedurës Penale (neni 255 i KPPK-së) dhe rezultati ka qenë pozitiv. Hutimi i shprehur nga avokati mbrojtës Millaku rreth procedurës së identifikimit është hequr kur është konfirmuar në gjykatë se avokati mbrojtës i të akuzuarit ka qenë prezent në marrjen në pyetje të dëshmitarit dhe asnjë sugjerim nuk i është dhënë dëshmitarit..

Dëshmitarët A B dhe J M kanë identifikuar pjesërisht të akuzuarit Hoti dhe Qela.

Dëshmitarja M nuk ka mundur të vijë në gjykatë për t'i konfirmuar deklaratat e saj të mëhershme, për shkak të gjendjes së saj të keqësuar shëndetësore, gjë që ia ka imponuar një periudhë shërimi dhe trajtimi jashtë vendit. Dokumentacioni arsyetues i është dorëzuar trupit gjykues gjatë mbajtës së seancës me datën 26 tetor nga ana e J K, që është vëllai i J Mt.

Në bazë të dokumentacionit, më kërkesë të prokurorit, trupi gjykues në fund të gjykimit ka vendosur që t'i fus deklaratat e dëshmitarëve në prova në pajtim me nenin 368 të KPPK-së. Ky vendim ishte marrë gjatë mbajtjes së seancës (faqja . e procesverbalit).

Deklarata e Anton Berishës në gjykatë ka qenë kryesisht e një ndihmese të vogël. Përveç përshkrimit të sulmit, atij i është kujtuar se në kohën e marrjes në pyetje nga prokurori, atij i janë treguar fotografitë dhe se ai ka qenë në gjendje ta dallojë një individ që i ka ngjasuar njërit prej sulmuesve. Ai ka thënë se konkludimi i tij është më tepër i bazuar përshtypje sesa në rikujtimin e vendosur të fakteve.

Gjithashtu, edhe identifikimi nga ana e J Mt mund të shihet si një element i vërtetimit të numrit të madhe të provave kundër Mentor Qeles dhe Agim Hotit në lidhje me ngjarjen e parë. Nuk mund të mohohet se vlera e ti reale është modeste dhe, si i vetëm, ky element nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arsyetuar deklarinimin e fajësisë. Megjithatë, deklaratat e Jetmires nuk është e izoluar dhe përputhet me fragmentet tjera të provave, pa kontradikta substanciale.

3) Provat e mbledhura nga raporti i patrullës policore.

Një dokument i dosjes së lëndës dëshmon në mënyrë të pakontestueshme kalimin e Mentor Qeles në rrugën ndërmjet Prishtinës dhe Pejës, disa kilometra nga vendi ku ka ndodhur ngjarja e parë, pak më shumë se një orë para kryerjes së sulmit në veturën e Anton Berishës.

Ky dokument është një raport i datës 28.2.2007, i përpiluar nga policët të cilët po patrullonin në rrugë në Llozicë dhe të cilat e kanë kontrolluar një Volkswagen Passat të të akuzuarit Mentor Qela në mëngjesin e ditës kritike sipas një ko incidence të thjeshtë.

Mentor Qela nuk e ka kontestuar praninë e tij në kohën dhe vendin e cekur në dokument. Megjithatë, ai ka sqaruar se po voziste në drejtim të Prishtinës sepse po shkonte për ta takuar shokun e tij (Petrit Nn) me të cilin ai duhet të zgjidhte një çështje rreth një prone të

paluajtshme. Për këtë arsye, atij i duhej të shkonte në kryeqytet herët në mëngjes, pasi që ata duhej të merrnin një dokument në Gjykatë Komunale në Prishtinë. Kur është pyetur nëse kishte arritur të merrte vërtetimin në gjykatë atë ditë, ai është përgjigjur se kur kishte shkuar në gjykatën komunale ishte shumë vonë, pasi që aty kishte një varg të gjatë të njerëzve që tanimë po prisnin jashtë gjykatës dhe personeli i gjykatës nuk e ka lejuar të hyjë brenda. Ai nuk ka thënë se kishte provuar përsëri në ndonjë rast tjetër në ndonjë ditë tjetër.

Sa i përket këtyre rrethanave, ai nuk ka paraqitur ndonjë provë, e as nuk ka kërkuar të bëjë këtë. Nuk ka pasur ndonjë kërkesë për ta ftuar dikën si dëshmitar, nuk ka pasur ndonjë copë letër për ta arsyetuar këtë.

4) Argumenti logjik.

Në kohën e këtyre ngjarjeve, dmth. në pranverë të vitit 2007, A B mbante një post të një rëndësie të madhe për zhvillimin e një biznesi strategjik në një shoqëri moderne. Si person përgjegjës i agjencisë për kontrollimin tregut të komunikimeve telefonike ai është dashur të marrë vendime të cilat mund të krijonin pakënaqësi në mesin e sektorëve të ndryshëm të shoqërisë.

I njëjti dëshmitar, gjatë marrjes së tij në pyetje (seanca e mbajtur me 3.11.09, faqe 6) ka përmendur tri çështje potenciale eksplozive: *“...liberalizimin e tregut duke hequr monopolin e PTK-së çështja e dytë kanë qenë antenat e serbëve, të cilat në si agjenci i kemi hequr disa antena, dhe çështja e tretë ka qenë palët të cilat nuk kanë fituar tenderin të cilat kanë qenë me të vërtetë të pakënaqura pasi që ka qenë një projekt i madh.... Kjo ka qenë detyra jonë por ka pasur të tjerë të cilët kanë menduar të pasurohen dhe nuk e kanë qarë kokën për shoqërinë...”*.

Prandaj nuk është çudi se ai mund ta ketë ngjallur zili, urrejtje dhe madje edhe rrezik për vetë jetën e tij.

Por gjithashtu në një shoqëri si Kosova, me një disponueshmëri jashtëzakonisht të madhe të armëve dhe me një lloj gatishmërie që të kërkohen zgjidhje ekstreme mund të mendohet se në të njëjtën kohë dy individë të ndryshëm apo dy grupe të individëve të ndryshëm po shtyheshin në masë të madhe në planifikimin e vdekjes së Anton Berishës.

Dy ngjarje janë gjithashtu të ndërlidhura në këtë: ato përfaqësojnë zbatimin e një plani unik (të keq perceptuar dhe fatmirësisht të dështuar). Nuk është reale të mendohet se sapo kishte dështuar përpjekja e parë, shfaqet një grup tjetër kriminelësh me qëllim të përfundimit të punës që sulmuesit e parë nuk kishin qenë në gjendje ta kryenin.

- - -

Argumentet e ilustruara deri me tani sqarojnë në mënyrë të pakontestueshme përgjegjësinë penale të të akuzuarve Agim Hotit, Mentor Qeles dhe Driton Spahiut për kryerjen e veprave penale për të cilat ngarkohen sipas pikës 1 të aktakuzës.

Por ato gjithashtu arsyetojnë, pa asnjë dyshim të arsyeshëm, se që të tre janë përgjegjës për posedim, mbajtje apo thjesht përdorim të armëve për të cilat nuk kanë pasur autorizim ligjor.

Për këtë arsye edhe pikat 2, 3 dhe 4 janë dëshmuar, pa pasur nevojë për një ilustrim specifik të detajeve të akuzave, të cilat janë të vetëkuptueshme: nëse sulmet ishin kryer nga të akuzuarit me armë automatike, granata dore, lansues raketash dhe, nëse të akuzuarit nuk kanë pasur leje për posedim të armëve të tilla, atëherë është e qartë se ata kanë kryer krimin e paraparë në nenin 328 të KPK-së.

- - -

Për vërtetimin e fakteve, është e nevojshme që të shqyrtohen edhe disa elemente për kualifikimin ligjor të krimeve.

Krimi i parë i cekur në aktakuzë është tentim vrasja e rëndë në bashkëkryerje sipas nenit 147 dhe nenit 23 të KPK-së.

Trupi gjykues e kupton se vullneti i kryerësve ka qenë i drejtuar në vrasjen e Anton Berishë si në tentimin e parë ashtu edhe në të dytën.

Agim Hoti dhe Mentor Qela janë pozicionuar në skaj të rrugës (me 28 shkurt 2007) dhe kur vetura e drejtuar nga J K po kalonte, ata kanë shtirë në një distancë të shkurtër me revole dhe me pushkë AK 47 potenciali vdekje prurës i të cilës është mjaftë mirë i njohur. Po të mos kishte qenë ngathtësia e tyre në kryerjen e sulmit, ata lehtë kanë mundur t'i arrijnë objektivat e tyre duke vrarë apo plagosur rëndë të katër pasagjerët në veturë..

Në mënyrë të ngjashme, me 12 prill 2007, ka qenë vetëm për shkak të koincidence dhe prapë për shkak të ngathtësisë së (këtë herë të trevë) sulmuesve që A B dhe personat që po e shoqëronin i janë shmangur vdekjes.

Në këtë rast, eksplozimi i raketave nuk ka ndodhur për arsyet që nuk janë shpjeguar gjatë mbajtjes së gjykimit por të cilat nuk janë të lidhura me efikasitetin e armatimit, siç është sqaruar në raportin balistik (mbase, objektivi ka qenë tepër afër kështu që raketa nuk e ka arritur shpejtësinë e nevojshme për aktivizimin e detonatorit).

Në të dy rastet, vullneti për marrje jete është i qartë. Arsyetim i paraqitur nga Hoti gjatë marrjes në pyetje se qëllim i tij ka qenë vetëm ta frikësojë të dëmtuarin është qartazi i pabazuar dhe naiv, duke marrë parasysh se madje edhe një fëmijë e kupton se goditja e një veture me raketë, qoftë ajo edhe e blinduar, ka pasoja potenciale vdekjeprurëse.

Si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, sulmuesit kanë pranuar pasojat shkatërruese dhe vdekjeprurëse të veprimeve të tyre. Më fjalë tjera, qëllimi kriminal i veprimit (dhmth. vullneti dhe qëllimi i veprimit) përfshin të gjitha pasojat e mundshme të veprimit dhe i kanë pranuar ato si dëme anësore. Në këtë kuptim, vullneti i Hotit, Qeles (dhe Spahiut për

ngjarje e dytë) mund të përshkruhet si një gjendje specifike e mendjes mendor ku ekziston një parashikim i një numri opsionesh si rezultat i mundshëm i veprës penale (J K, J M dhe të afërmit e tyre, në rastin e parë; personat që shoqëronin Berishën në rastin e dytë). Viktimat 'sekondare' (në krahasim me Berishën, i cili ka qenë viktimë 'primare') mund të mos jenë synimi i drejtpërdrejt i veprimit por megjithatë janë konsideruar si të pashmangshëm dhe janë pranuar për arritjen e objektivit. Vullneti i kryerësit(ve), duke ditur pasojat e parashikueshme dhe të parapara vdekjeprurëse, demonstroi mbizotërimin e përcaktimit kriminal ndaj interesave tjera (mbrojtjen e jetës, integritetit trupor, apo pronës), të cilat prandaj janë degjeneruese dhe asgjësuese.

Si përfundim, në lidhje me sulmet kundër Anton Berishës dhe atyre që e shoqëronin atë, kualifikimi i fakteve si tentim vrasje është i saktë. Dhe ky kualifikim rëndohet nga paraqitja e rrethanave sipas nenit 147 të KPK-së. Të gjitha këto tri rrethana mund të identifikohen lehtë në lidhje me numrin e jetëve që janë rrezikuar, për arsye të ulëta, dhe me numrin e viktimave të prekura nga akti. Të gjitha këto rrethana, të cilat janë të vetëkuptueshme sipas mendimit të trupit gjykues, nuk kërkojnë ilustrim specifik.

- - -

Disa vlerësimi të përgjithshme rreth gjykimit dhe tre të akuzuarve Hoti, Qela dhe Spahiu në konkludim të aktgjykimit.

Motivi i krimit dhe qëllimi i tij janë ilustruar më lartë. E kemi parë se ka ekzistuar një marrëveshje dhe bashkërendim ndërmjet të pandehurve, kështu që vullneti që ka karakterizuar veprimin ka qenë kolektiv. Tani mund të shtojmë se ka qenë kushti psikologji që, sapo është vërtetuar, i ka detyruar në mënyrë reciproke anëtarët e grupit të cilët kanë marrë pjesë në krim. Është vullneti ai që qartazi (për fjalët e thëna apo kërkesat e paraqitura nga dikush në grup) apo në mënyrë të nënkuptuar (për kodin e nderit ndërmjet individëve të së njëjtin mjedis) përfshin rregullën e heshtjes që ia parandalon një pjesëmarrësi, në rast të zbulimit apo arrestimit, t'ua tregojë hetuesve apo gjyqtarëve identitetin e pjesëmarrësve tjerë në veprim.

Kjo është mjaft e dukshme në rastin e tanishëm.

Agim Hoti, përkundër të gjitha provave që tregojnë për një veprim kolektiv, ka ripërsëritur '*Unë jam Agimi, kam qenë me vetën time*', qartazi tregon se ai nuk dëshiron që t'i përfshijë të tjerët në pohimin e tij.

Natyrisht, kjo është një alternativë e lirë, në të cilën trupi gjykues nuk mund të ndërhyjë, pasi që kjo do të ishte shkelje e rregullës *nemo tenetur se detegere* (askush nuk ka për detyrë të vetë-akuzohet) si i tillë. Siç dihet, në rrethet kriminale si dhe në kontekstin e vjetër kulturor, ndjenja e lojalitetit është e pakontestueshme, madje edhe nëse shkel obligimet ndaj shoqërisë demokratike. Shkelja e kodit të tillë të nderit do të sillte zemërim të madh dhe turpërim për 'tradhtarin'. Kjo nënkupton se qëllim kriminal që fillimisht është përcaktuar për kryerjen e krimeve është ende i gjallë dhe aktiv si dhe detyruar për tre të akuzuarit, në këtë aspekt. Dhe paraqet një pengesë të pakapërcyeshme,

për ta, për t'u bërë dëshmitar bashkëpunues të prokurorit. Në vend që të zgjedhin një opsion me të përshtatshëm të gjyqimit (duke u bërë dëshmitarë bashkëpunues, ata kanë mundur të mbështetën në nenin 289 të KPPK-së dhe të arrijnë një marrëveshje me prokurorin apo të deklarohen fajtor, duke fituar një shkurtim të konsiderueshme të afatit të burgimit) ata kanë preferuar të ballafaqohen me gjykimin dhe ta marrin dënimin e plotë. Për shkak të bindjes së tyre ndaj vullnetit fillestar kriminal dhe ndaj këtij kodi të vjetruar të nderit, nuk ekziston ndonjë mundësi për pranimin e zvogëlimit të dënimit..

Ka qenë e qartë për gjyqtarët se tre të akuzuarit Hoti, Qela dhe Spahiu, madje edhe nëse më të vërtetë janë përgjegjës për sulmet që kanë kryer, nuk kanë qenë të vetë-inspiruar. Ata kanë qenë vetëm mercenarë.

Çfarë interesi personal kanë mundur të kenë për ta vrarë Anton Berishën, çfarë motivi? A mos duhet trupë gjykues t'ju besojë fjalëve të Agim Hotit, i cili ka pohuar se kishte shtirë me lansues raketash nga zemërimi për shkak të keqpërdorimit të supozuar të Anton Berishës në administrimin e Autoriteti Rregullativ të Telekomunikacionit?

Dhe ky është një motiv mjaft i dobët për ta frymëzuar 'treshen' e kriminelëve (Hoti, Qela, Spahiu) që të përgatiten me lansues raketash dhe granata dore si dhe me armë aq të shtrenjta dhe të një teknologjie të avancuar të cilat nuk mund të gjinden lehtë madje edhe në territorin e Kosovës?

Por përkundër këtyre vërejtjeve, tre të pandehurit janë mbërthyer për murit të heshtjes, duke qenë mirë të vetëdijshëm se duke folur dhe akuzuar nxitësin e tyre do të ishte më e rrezikshme sesa vitet e kaluara në burg. Më mirë të rrezikojnë me dënim deri në disa vite sesa me jetë....

Duke zgjedhur heshtje, tre të pandehurit ua kanë bërë të pamundshme hetuesve që të ndjekin zinxhirin e përgjegjësisë dhe të arrijnë tek emri i individit që kishte kërkuar nga ta t'i kryejnë krimet.

Duke bërë këtë, tre të pandehurit kanë ngritur dhe forcuar marrëveshjen ndërmjet tyre dhe me nxitësin e vërtetë të aktivitetit kriminal (që ka mbetur i panjohur) si dhe të flasin në këtë mënyrë, duke treguar lojalitetin e tyre ndaj atyre që i kanë urdhëruar.

Pesha e dënimit në këtë rast arsyetohet me numrin e viktimave të mundshme të tentim vrasjeve dhe me shkallën e mosrespektimit për jetën njerëzore të treguar nga autorët e krimeve, të cilët kanë qenë të gatshëm që të shkaktojnë një numër të madhe viktimash për përmbushjen e planit të tyre për ta vrarë Anton Berishën. Hoti, Qela dhe Spahiu, të cilët tani bëjnë thirrje dhe vajtojnë se gjoja kanë qenë viktimat të keqtrajtimit, nuk kanë hezituar të lansojnë raketa dhe granata kundër pjesëtarëve të eskortës së Anton Berishë të cilët janë parë vetëm si 'dëme anësore' dhe jeta e të cilëve, natyrisht, duhet të mos ketë pasur shumë vlerë, sipas mendimit të të pandehurve.

Në përcaktimin e masës së dënimit për secilin të pandehur dhe në lidhje me dy akuzat kryesore (tentim vrasjet), trupi gjykues mendon se është e duhur që të shqyrtohen faktorët si në vijim.

Ngjarja e dytë (e 12 prillit 2007) është padyshim më e rëndë sa i përket numrit të viktimave të mundshme, sa i përket potencialit të armëve të përdorura dhe për shkak se tregon këmbënguljen dhe vendosmërinë e fuqishme për të kryer sulmin edhe pse përpjekja e parë kishte dështuar para një muaji e gjysmë më parë. Këmbëngulja ka ilustrua mirë përcaktimin kriminal të Qeles dhe Hotit të cilët nuk kanë treguar ndonjë ndjenjë keqardhje apo ri-mendimi ndërmjet sulmit të parë dhe të dytë.

Po të kishte qenë sulmi i suksesshëm dhe të pandehurit të kishin arritur objektivin e tyre, dënimin nuk do të kishte qenë më i vogël se tridhjetë vite burgim.

Zvogëlimi për tentim vrasje e sjell dënimin në 20 vite burgim. Ky do të jetë dënimi për Qelen.

Për Agim Hotin dhe Driton Spahiun, ekzistojnë arsye për zbutjen e mëtejme të dënimit.

Agim Hoti ka pranuar pjesërisht krimin e tij. Ndonëse pranimi i fajësisë nuk kishte qenë i plotë dhe kishte shpenzuar në çdo mënyrë aktivitetin gjyqësor apo kohën e gjykatës, ai megjithatë ka kontribuar në rindërtimin faktik të ngjarjeve dhe në përcaktimin pasues të përgjegjësisë së të pandehurve. Për këtë arsye, në lidhje me Hotin, dënimi për ngjarjen e dytë është kufizuar në 14 vite burgim, që paraqet zvogëlim për afërsisht prej një të tretës së dënimit që i është caktuar Qeles.

Sa i përket Driton Spahiut, arsyeja për zbutjen e dënimit të tij rrjedhe nga përfshirja e tij e rastësishme. Nëse është e pakontestueshme se ai ka marrë pjesë në veprimin kriminal (gjurmët e gishtërinjve të tij janë gjetur në lansuesin e raketave; në momentin e arrestimit ai ka qenë në posedim të dy granatave), atëherë është mjaft e qartë se kontributi i tij nuk ka qenë kryesor dhe se ai u është bashkuar dy të tjerëve të cilat tashmë kishin përgatitur kryerjen e krimit dhe kishin blerë armët. Megjithatë, rrethana se ai ka refuzuar të pranojë pjesëmarrjen e tij përkundër provave në dispozicion (gjurmët e gishtërinjve dhe granatat) e parandalon trupin gjykues që t'i jap këtij të pandehuri të njëjtin trajtim të favorshëm sikurse Hotit.

Ngjarja e parë që ka ndodhur me 28 shkurt 2007, ka rrezikuar në mënyrë të barabartë jetën e katër personave. Megjithatë, për shkak të llojit të armeve të përdoruar, mund të konsiderohet si më e lehtë. Kjo është reflektuar në dënimin e shqiptuar kundër të dyshuarve (Qela dhe Hoti) të cilëve u janë shqiptuar 7 respektivisht 12 vite burgim. Duhet të ceket se trajtimi më i mirë për Hotin arsyetohet me pranimin e fajësisë së tij.

Qela, Hoti dhe Spahi janë gjithashtu përgjegjës për mbajtjen e armëve të përdorura për kryerjen e krimeve.

Për këtë akuzë, dy të parëve (Qeles dhe Hotit) u janë shqiptuar nga një vit e katër muaj burgim shtesë, ndërsa Spahiut i janë shqiptuar vetëm dhjetë muaj, pasi që ai akuzohet për mbajtje të paligjshme të armëve vetën në një rast, dmth. gjatë kryerjes së sulmit të dytë.

Në zbatimin e rregullit për shqiptimin e dënimit për veprat e përgjithshme penale, në pajtim me nenin 71, paragrafin 1 dhe 2, pikën 2 të KPK-së, të pandehurve ju shqiptohen dënimet përfundimtare me burgim: 16 vite për Hotin, 20 vite për Qelen dhe gjashtë muaj për Spahiun.

Koha të cilën të pandehurit Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahi u kanë kaluar në paraburgim nga 12 prill 2007 deri kur marrjen e aktgjykimit të plotfuqishëm do të llogaritet si pjesë e burgimit në pajtim me nenin 73 të KPK-së.

Në përfundim të marrjes në pyetje të të pandehurve, me 11 nëntor 2009, prokurori ka tërhequr akuzën A Nt, në lidhje me pikën e fundit të aktakuzës.

Si rrjedhojë, trupi gjykues, në pajtim me nenin 389 të KPPK-së, hedh poshtë akuzën kundër të akuzuarit.

Sulmi në automjetin e drejtuar nga I G me 12 prill 2007 ka rezultuar në lëndimet e këmbës së I Gt. Kjo rrethanë është konfirmuar nga deklaratat e viktimës së njëjtë dhe kolegëve të tij si dhe nga dokumentacioni mjekësor në dosje të lëndës.

Të akuzuarit Agim Hoti, Mentor Qela dhe Driton Spahi, në mënyrë kolektive dhe së bashku, duhet ta kompensojnë të dëmtuarin I Gn për dëmet e shkaktuara.

Megjithatë, Të dhënat e paraqitura në procedurën penale nuk ofrojnë një pazë të besueshme për një kompensim të plotë apo të pjesshëm pasi që mungon një pjesë e madhe e informatave (si në aspektin e humbjes ekonomike/fitimet e vogla ashtu edhe në aspektin e paaftësisë afatgjate për punë të shkaktuar nga lëndimi; nuk ekzistojnë informata në dispozicion lidhur me kompensimin alternativ që tashmë është pranuar nga viktima, nëse ka pasur); prandaj gjykata e udhëzon të dëmtuarin që të paraqes një padi civile për tërë kërkesën në pajtim me nenin 112 (2) të KPPK-së.

Në pajtim me nenin 102, paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), personat e dënuar detyrohen që t'i paguajnë shpenzimet procedurale të cilat duhet të paguhen në shumën e përgjithshme prej 350 euro.

Në pajtim me Nenin 60 të KPPK-së urdhërohet konfiskimi i armëve të kapura gjatë hetimit.

Data: 20 nëntor 2009

Kryetari i trupit gjykues
Francesco Florit

Anëtari i trupit gjykues
Ferid Beslimi

Anëtari i trupit gjykues
Dragomir Yordanov

Këshillë juridike:

Në pajtim me nenin 400 (1) KPPK-së, ankesa duhet të bëhet e ditur 8 ditë nga njoftimi i këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 398(1) KPPK-së, ankesa duhet t'i parashtrahet kësaj gjykate brenda 15 ditëve nga data dorëzimit të kopjes së këtij aktgjykimi palëve.